REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 3573
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 11
Data/Datum/Date: 10.09.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**
**QEVERIA E KOSOVËS /VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**
**MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA**
**MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së

Data: 10.09.2021

## PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
### të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

| ÇËSHTJET – TË GJETURAT | REKOMANDIMET | VEPRIMET E PLANIFIKUARA PËR TU NDËRMARRË | ZYRTARËT PËRGJEGJËS | DATA E PLANIFIKUAR E ZBATIMIT TË REKOMANDIMIT | KOMENTET |
|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. ***AZhB-ja nuk kishte të aprovuar strategjinë, politikat dhe procedurat e brendshme të TI-së*** | *Të hartojë dhe të aprovojë strategjinë, politikat dhe procedurat e TI-së në mënyrë që të udhëzojnë funksionet e TI-së dhe njëkohësisht të krijojnë mekanizma që sigurojnë që këto janë duke u ndjekur për t'u siguruar që TI-ja është duke mbështetur objektivat e institucionit;* | **AZHB-ja posedon një draft strategji e cila duhet të rishikohet dhe plotësohet se bashku me procedurat e Ti-së** | **Kryeshefi i AZHB-se dhe Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2022** | |
| 2. ***AZhB-ja kishte mangësi në identifikimin dhe monitorimin e nevojave dhe rreziqeve në fushën e TI-së*** | *Të përcaktojë një proces për identifikimin e nevojave dhe rreziqeve në fushën e TI-së. Të sigurohet që mekanizmat monitories përpilojnë raporte përmbledhëse dhe analitike që tregojnë për rezultatet e arritura, ngecjet e identifikuara, si dhe veprimet për korrigjimin e devijimeve për arritjen e objektivave të sajë;* | **AZHB-ja ka bërë identifikimin e mungeses se stafit në DTI dhe përmirësimeve të nevojshme në sistem ku është bërë kërkesa për zhvillimin e sistemit të ri për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve.** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së Prokurimi** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | **Ky rekomandim varet nga rregullorja për sistematizimin e vëndeve të punës në AZHB** |
| 3. ***AZhB-ja nuk kishte bërë vlerësim të performancës së aplikacioneve që kishte në shfrytëzim*** | *Të sigurojë se projektet e TI-së janë duke e arritur qëllimin e tyre dhe janë duke u shfrytëzuar në harmoni me rregulloret e paracaktuara duke caktuar një* | **Ndonëse AZHB-ja e ka bërë një vlerësim të tillë dhe ka ardhur** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së Të gjitha Departamentet** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | *personel/grup punues për sigurimin e cilësisë. Të cilët sistematikisht duhet të vlerësojnë produktet e punës, për të parë që ato plotësojnë standardet dhe cilësitë e dokumentuara të organizatës dhe nëse janë duke u ndjekur proceset e nevojshme për zhvillimin e produkteve;* | **në përfundim që duhet të zhvillohet një sistem i ri por i njejti nuk është dokumentuar. AZHB do të siguroj që në të ardhmen vlerësimet e tilla të dokumentohen në harmoni me rekomandimet e ZKA-së** | **e nderlidhura** | | |
| ***4. Të dhënat në Regjistrin Elektronik të Fermerëve nuk janë në harmoni me udhëzimet administrative për regjistrin e fermerëve*** | *Të sigurojë që në aplikacione janë vendosur kontrollet e duhura që aplikacioni të procedoj vetëm të dhënat në harmoni me udhëzimin administrativ;* | **AZHB-ja do të bëjë plotësim ndryshimin e UA për regjistrin e fermerëve si dhe do të bëjë zhvillimin e më tutjeshem te regjistrit elektorink të fermereve duke siguruar qe keto dyja të jene ne harmoni të** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2022** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | plotë | | | |
| ***5. Në AZhB nuk kishte një ambient testues të aplikacioneve të cilat do të shfrytëzoheshin për testime para vendosjes së ndryshimeve në ambientin produktiv*** | *Të sigurojë që të gjitha testimet e aplikacioneve bëhen në një ambient testues dhe vetëm pas testimit nga palët përgjegjëse, të njëjtat kalojnë në ambient produktiv.* *Qasja në ndryshime të sistemeve në ambient produktiv të jetë e kufizuar;* | **Në sistemin e ri të TI-së në AZHB do të krijohen ambiente testuese dhe vetem pas testimit do të kalohet në ambient real.** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2021 dhe 2022** | |
| ***6. Në aplikacionet e zhvilluara në AZhB kishte mungesë të vendosjes së kontrolleve të vlefshmërisë gjatë vendosjes së të dhënave*** | *Të sigurojë që në aplikacionet në shfrytëzim, rregullat e vlefshmërisë janë të mirë hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e të dhënave hyrëse në mënyrë që të pamundësohet vendosja e të dhënave të gabuara në aplikacion;* | **AZHB-ja do të siguroj që në sistemin e ri që do të zhvillohet të vendosen kontrollet e vlefshmerisë gjatë vendosjes se të dhënave.** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2021 dhe 2022** | |
| ***7. Aplikacionet e zhvilluara në AZhB nuk kishin ndërlidhje me sistemet bazë të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës*** | *Të sigurojë ndërlidhjet e nevojshme të aplikacioneve në shfrytëzim me sistemet bazë të Republikës së Kosovës në mënyrë që sistemet të pranojnë vetëm të dhëna të sakta;* | **AZHB-ja planifikon lidhjen e Memorandumeve të bashkëpunimit më te gjitha** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2021 dhe 2022** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **institucionet e nderlidhura dhe integrimin e sistemeve për shkembim te të dhënave.** | | | |
| ***8. Jo të gjitha proceset e punës janë definuar edhe në aplikacionet përkatëse.*** | *Të sigurojë se rrjedha e punës në aplikacionet për menaxhimin e pagesave direkte dhe të programeve për zhvillimin rural përkrahin të gjitha proceset e punës dhe të jenë në harmoni të plotë me udhëzimet administrative;* | **Në procesin e zhvillimit të sistemit të ri për menaxhimin e granteve dhe subvenciove do të sigurohet se rrjedha e punës në aplikacionet për menaxhimin e pagesave direkte dhe të programeve për zhvillimin rural përkrahin të gjitha proceset e punës dhe të jenë në harmoni të plotë me udhëzimet administrative** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| ***9. Në aplikacionet e zhvilluara në AZhB kishte mungesë të mesazheve të gabimeve gjatë përpunimit të të dhënave dhe nuk kishte një proces të definuar për trajtimin e gabimeve apo incidenteve të ndodhura*** | *Të hartojë një procedurë për menaxhimin e incidenteve dhe problemeve të teknologjisë së informacionit. Po ashtu të krijojë një proces apo sistem lidhur me mbledhjen, trajtimin, menaxhimin dhe ruajtjen e tyre, me qëllim të minimizimit incidenteve dhe problemeve në të ardhmen;* | **Në zhvillimin e sistemit të ri do të sigurohet që të ketë mesazhe të nevojshme te gabimeve gjatë perdorimit të sistemit. Krahas kësaj do të hartojë edhe një procedurë për mbledhjen, trajtimin, menaxhimin dhe historinë e gabimeve/incidenteve të raportuara.** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | |
| ***10. AZhB-ja nuk kishte mjaftueshëm raporte të krijuara në aplikacione.*** | *Të përshkruajë në procedura të brendshme procesin e nxjerrjes, përpunimit dhe publikimit të raporteve për palët e treta. Po ashtu, të krijojë një listë të raporteve të nevojshme për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe të konfigurojë sistemet që i ka në përdorim në mënyrë që të gjenerojë raporte të ndryshme statistikore, të cilat do të lehtësonin procesin e punës dhe* | **AZHB ka planifikuar që sistemi i ri që do të zhvillohet të ofrojë një gamë të gjërë të raporteve të rregullta dhe sipas nevojave specifike për përdoruesit e brendshëm dhe** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | *eliminonin punën manuale;* | **të jashtëm.** | | | |
| ***11. Raportet e publikuara të AZhB-së nuk janë në përputhje me të dhënat në bazën e të dhënave, si dhe përmbajnë të dhëna personale.*** | *Të përcaktojë nivelet e kontrollit të të dhënave në raporte, para se të njëjtat të përdoren, duhet të sigurohet se të dhënat e nxjerra nga sistemet të cilat i ka në përdorim janë të sakta dhe të plota. Gjithashtu, duhet të sigurojë që raportet që publikohen në ueb faqen zyrtare të publikohen në bashkëpunim me zyrën ligjore dhe në harmoni me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;* | **AZHB do të sigurojë që raportet e publikuara të jenë në harmoni me bazën e të dhënave. Në kuadër të procedurave të brendshme të AZHB-së do të sigurohet që të dhënat personale të jenë të mbrojtura sipas kërkesave ligjore.** | **Kryeshefi i AZHB-se, Zyra Ligjore, Departamentet e ndëerlidhura.** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | |
| ***12. AZhB-ja ka bazat e të dhënave të pa gjurmueshme ndaj ndryshimeve të cilat bëhen direkt në bazën e të dhënave.*** | *Të hartojë një procedurë gjithëpërfshirëse sa i përket menaxhimit të gjurmëve të aktiviteteve të përdoruesve në sistemet e informacionit. Kjo procedurë duhet të përfshijë proceset lidhur me llojin e* | **AZHB do të sigurojë që në të ardhmen të ketë një procedurë gjithëpërfshirës e lidhur me** | **Kryeshefi i AZHB-se, Zyra Ligjore, Departamentet e ndëerlidhura.** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | *gjurmëve që duhet të mblidhen, vendin e ruajtjes së tyre, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me qasjen në këto të dhëna, periudhën e ruajtjes së tyre, si dhe monitorimin periodik të tyre. Po ashtu, të krijojë një mekanizëm të monitorimit periodik të gjurmëve të aktiviteteve, me qëllim të identifikimit dhe eliminimit të gabimeve dhe keqpërdorimeve eventuale;* | **llojin e gjurmëve që duhet të mblidhen, vendin e ruajtjes së tyre, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me qasjen në këto të dhëna, periudhën e ruajtjes së tyre, si dhe monitorimin periodik të tyre. Krahas kësaj do të krojohet edhe një mekanizëm të monitorimit periodik të gjurmëve të aktiviteteve, me qëllim të identifikimit dhe eliminimit të gabimeve dhe keqpërdorimev e eventuale** | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| ***13. AZhB-ja nuk ka të krijuar një program të vetëdijesimit të stafit në lidhje me çështjet e sigurisë.*** | *Me qëllim të vetëdijesimit të stafit për rreziqet në lidhje me sigurinë e sistemeve të informacionit duhet të krijoj një program të ndërgjegjësimit në lidhje me proceset e sigurisë dhe të trajnoj stafin e AZhB-së në periudha të caktuara. Po ashtu, të ndërmarr veprime të menjëhershme për eliminimin e mangësive të identifikuara sa i përket çështjeve të sigurisë;* | **DTI në bashkëpunim me Burimet Njerëzore do të përgatit dhe realizojë një program adekuat të trajnimit për të gjithë stafin e AZHB-se lidhur me vetëdijësimin ë tyre për qështjet e sigurisë. Po ashtu në sistemin e ri që do të zhvillohet do të mundësohen vetëm fjalë-kalime të enkriptuara dhe komplekse.** | **Kryeshefi i AZHB-se, Drejtori i TI-së** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | |
| ***14. AZhB-ja nuk ka matricë të qasjeve, nga ku do të përcaktoheshin nivelet e qasjeve sipas pozitave në infrastrukturën e TI-së.*** | *Të krijojë mekanizma të cilët do të trajtojnë çështjet e realizmit të qasjeve, të cilët duhet të parashohin procesin e lejimit të qasjeve, vlerësimin e rreziqeve që mund t'i kenë qasjet e lejuara,* | **AZHB do të sigurojë matricë të qasjev ku do të përcaktoheshin nivelet e** | **Kryeshefi i AZHB-se,<br><br>Departamentet e ndërlidhura.** | **Gjatë vitit 2022 dhe 2023** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | *procesin e mbylljes së përdoruesve, rishikimin periodik etj. Gjithashtu, të bëjë vlerësimin e rreziqeve të qasjeve të lejuara duke krijuar një matricë të niveleve të qasjeve sipas proceseve të punës dhe pozitës, në mënyrë që procesi i lejimit dhe rishikimit të jetë i menaxhueshëm;* | **qasjeve sipas pozitave në infrastrukturën e TI-së.** | | | |
| ***15. Në sistemet e informacionit kishte llogari aktive të përdoruesve edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, si dhe nuk kërkohet ndryshimi i fjalëkalimit të llogarive zyrtare.*** | *Të sigurojë se procesi i lejimit, monitorimit dhe mbylljes së përdoruesve të jetë në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore duke u bazuar në kornizën rregullative në fuqi. Për më tepër të gjithë përdoruesit në Active Directory dhe në sistemet e tjera duhet të konfigurohen në bazë të kornizës rregullative në mënyrë që fjalëkalimet të kenë kompleksitetin e duhur dhe të ndryshohen në periudha të caktuara;* | **Kjo çështje është adresuar menjëherë pas identifikimit nga ana e auditorëve dhe AZHB do të sigurojë që rastet e tilla të trajtohen sipas rekomandimit të ZKA-së.** | **Kryeshefi i AZHB-se,**<br><br>**Burimet Njerëzore**<br><br>**Departamentet e ndërlidhura.** | **Rekomandim i zbatuar.** | |
| ***16. AZhB-ja nuk krijon llogari elektronike për të gjithë personat që kanë qasje në infrastrukturën e brendshme, mirëpo përdor llogari të përgjithshme apo administratorin lokal, si dhe nuk i monitoron qasjet në baza*** | *Të mos lejojë qasje të pa personalizuara në sistemet dhe infrastrukturën që e ka në përdorim, të ketë mekanizma të kontrollit në mënyrë që të eliminohen qasjet e panevojshme si dhe qasjet e zyrtarëve të monitorohen në mënyrë të* | **AZHB dë të sigurojë që të gjitha rekomandimet e ZKA-së për këtë çështje do të adresohen në një afat shumë** | **Kryeshefi i AZHB-se,**<br><br>**Departamentet e ndërlidhura.** | **Gjatë vitit 2021 dhe 2022** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| ***periodike.*** | *vazhdueshme. Po ashtu, qasja në bazat e të dhënave duhet të bëhet përmes përdoruesve të personalizuar dhe të mos përdoret përdoruesi Administrator i Sistemit (System Administrator-SA).* | **të shpejtë kohor.** | | | |